VENDIM
Nr. 230, datë 23.4.2014

PËR PËRBËRJEN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË SEKRETARIATIT TEKNIK TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 1, shkronja "b" e 11 të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, si organ ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Ujit, është institucion juridik publik, me seli në Tiranë.

2. Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, si një nga organet kombëtare të administrimit dhe të menaxhimit të burimeve ujore, ka objekt të veprimtarisë së tij projektimin dhe ngritjen e sistemit total të integruar të ujit dhe monitorimin e garantimin e funksionimit efikas të menaxhimit të integruar të këtij sistemi.

3. Funksionet dhe kompetencat e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit janë ato të përcaktuara në ligjin nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".

4. Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit financohet nga buxheti i shtetit dhe nga çdo burim tjetër financiar i ligjshëm.

5. Drejtuesi i Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të Kryeministrit, në cilësinë e kryetarit të Këshillit Kombëtar të Ujit.

6. Rregullorja e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit miratohet nga Këshilli Kombëtar i Ujit, sipas përcaktimeve të shkronjës "d", të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2012.

7. Vendimi nr. 910, datë 30.12.1996 i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit", shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama